



TRAJNIMI FILLESTAR DHE VAZHDI I AVOKATËVE

(PRAKTIKA DHE METODOLOGJI)

Prof. Dr. Mariana SEMINI-TUTULANI

30 Shtator 2016

- “Kur bën plane për një vit, atëherë mbill një fushë me misër. Kur planifikon për një dekadë, at[her[mbill pemë. Kur planifikon përjetë, trajno dhe eduko njerëz.”

Proverb kinez

SYNIMET E TRAJNIMIT FILLESTAR

- Rritja e aftësive praktike përmes procesit të të mësuarit;
- Përgatitja e trupës së avokatëve të rinj me njohuritë e nevojshme materiale dhe procedurale për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave sa më të mirë të klientëve;
- Përqasja e njohurive me standartet e legjislacionit të BE-së duke synuar respektimin e normave që lidhen me të drejtat e njeriut;
- Edukimi me praktikat e mira dhe me rregullat e duhura etike të qëndrimit, të sjelljes dhe të veprimit me palët e interesuara dhe pjesëmarrësit në procesin gjyqësor;
- Forcimi i tiparave të duhura të integritetit moral dhe profesional;
- Edukimi i shpirtit të drejtësisë dhe respektimi i shtetit ligjor.

RËNDËSIA E EKSPERIENCËS DHE E PRAKTIKËS

- ◉ *“Education is what remains after one has forgotten what one has learned in school.”*
- ◉ **“Edukimi është ajo që mbetet pasi ke harruar atë çfarë ke mësuar në shkollë“**
- ◉ *“Example isn't another way to teach, it is the only way to teach.”*
- ◉ **Shembulli nuk është një mënyrë tjetër për të mësuar, është e vetmja mënyrë për të mësuar.**

Albert Ajnshtain

RRITJA E AFTËSIVE PRAKTIKE

- ◉ Diskutimi i interaktiv i asistent avokatëve në grupe 25-30 veta lidhur me tema praktike të tilla si lidhja e kontratës, shpërblimi i dëmit, etj;
- ◉ rritja e aftësive në përgatitjen e dokumentave dhe ndërtimi i hapave të nevojshëm për të hartuar një kontratë, për të përgatitur një padi, për të ndërtuar strategjinë e mbrojtjes dhe për të prëgatitur listën e provave që do të mbështesin pretendimet e avokatit, përgatitja e fjalës së mbrojtjes, etj;
- ◉ Analizmi i dokumentave të përgatitur;
- ◉ Zgjidhja dhe diskutimi i rasteve të praktikës gjyqësore, duke evidentuar çështjet për diskutim dhe argumentimin e përgjigjes për secilën prej tyre;
- ◉ Luajtja e roleve të palëve ndërgjyqëse.

EDUKIMI ME PRAKTIKAT E MIRA DHE ME RREGULLAT E DUHURA ETIKE

- ◉ Të edukojmë mbrojtjen e interesit të palës duke mos shkelur mbi interesat publike;
- ◉ Të veprojmë me mirëbesim dhe me drejtësi;
- ◉ Të evidentojmë dallimin midis dhënies së drejtësisë dhe të qenit i drejtë;
- ◉ Të respektojmë pjesëmarrësit në hetim e gjykim;
- ◉ Të shmangim konfliktin e interesit dhe t'i largohemi tundimit për fitim me cdo kusht e me cdo mjet;
- ◉ Të ndjekim të vërtetën dhe të luftojmë për fitoren e saj;
- ◉ Të mos bëjmë kompromis me padrejtësinë dhe të mos bëjmë kompromis duke shkelur parimet.

KONSOLIDIMI DHE RESPEKTIMI I SHTETIT LIGJOR

- ◉ Ta lexojmë dhe zbatojmë ligjin në mënyrën e duhur dhe brenda kufijve të tij. Të mos i kalojmë kufijtë e ligjit për interesa të ngushta;
- ◉ Ta harmonizojmë legjislacionin kombëtar me legjislacionin ndërnkombëtar, aktet dhe konventat e ndrëkombëtare;
- ◉ Ta harmonizojmë praktikën gjyqësore shqiëptare me praktikën e GJEDNJ-së, të Gjykatës së Drejtësisë, etj;
- ◉ Ta interpretojmë ligjin vetëm kur është e nevojshme dhe vetëm duke respektuar rregullat e interpretimit shkencor;
- ◉ Të respektojmë pavarësinë dhe objektivitetin e procesit të drejtësisë.

SYNIMET E TRAJNIMIT VAZHDI TE AVOKATEVE

- Të freskojmë njohuritë duke analizuar ligjet e reja, amendimet e ligjeve ekzistuese, vendimet unifikuese të Gj.L, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, etj;
- Diskutojmë problemet dhe çështjet e diskutueshme ligjore, që nuk e gjejnë zgjidhjen në legjislacion;
- Të shkëmbejmë eksperiencat midis brezave të avokatëve;
- Të specializojmë avokatët në fusha më specifike: drejtësia për të mitur, fusha tregtare, transaksionet ndërkombëtare, arbitrazhi ndërkombëtar, falimentimi, gjykimi administrativ, kontraktimi në fushën administrative, etj.

RRUGËT E ARRITJES SË SYNIMEVE

- ◉ Seleksionimi i trajnerëve të kualifikuar me njohuritë e duhura në fushën akademike;
- ◉ Bashkëpunime me institucione dhe projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Projekti me USAID në 6 Dhoma Lokale: Vlorë, Durrës, Fier, Korçë, Shkodër, Tiranë;
- ◉ Rritja e kapaciteteve trajnuese të dhomave lokale të avokatisë;
- ◉ Botime profesionale dhe shkencore përmes periodikëve, etj;
- ◉ Vlerësimi i nevojave në mënyrë të specifikuar sipas problematikës së çështjeve në zona të caktuara, etj.

SFIDAT PËR TË ARDHMEN

- **Për Trajnimin Fillestar**
- **Monitorimi praktikës së asistent avokatëve; dhe**
- **Përfshirja e vlerësimit të praktikës së asistent avokatëve në vlerësimin përfundimtar të tyre;**
- **Seleksionimi i studiove ligjore dhe i avokatëve me eksperiencë që do të udhëheqin praktikat e asistentëve;**
- **Trajnimi i trajnerëve dhe udhëheqësve të praktikave.**
- **Për trajnimin vazhdues**
- **Shtrirja e trajnimit në të gjitha dhomat lokale;**
- **Organizimi i trajnimeve të specializuara për avokatët;**
- **Organizimi i trajnimit vazhdues brenda veprimtrisë aktive të SHKA-së;**
- **Organizimi i një programi të trajnimit azhdues të avokatëve 2017-2020.**

***JU FALEMINDERIT PËR
VËMENDJEN!***